




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel.0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) e Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, pa shqyrtimit të kërkesës së Këshillit të Fshatit Zhegër për rregullimit e Memorialit "KATANA" në fsh.Zhegër, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 06.11.2014, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e Vendosjes së Memorialit " KATANA"

1. Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon kërkesën e Këshillit të Fshatit Zhegër për vendosjen e Memorialit " KATANA" në fh.Zhegër.**
2. **Lejohet vendosja e Memorialit "KATANA" sipas projektit të bashkangjitur kërkesës në një pjesë të ngastrës kadastrale P-70403026-01657-3, lloji i njësisë – parcelë, zona –rurale, me sipërfaqe të përgjithshme prej 467332 m² (46.73.32 ha), prone e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Zona Kadastrale Zhegër. Sipërfaqja e nevojshme për Memorial është 16474 m² (01.64.74 ha) nga sipërfaqja e përgjithshme e ngastrës kadastrale të cekur më lartë.**
3. Investimi dhe ndërtimi i Memorialit bëhet me vetkontributet e qytetarëve të fshatit Zhegër dhe me donacionet e bashkëkombasëve nga diaspora.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës Komunale sipas sipërfaqes së nevojshme për Memorialin kurse titullari i kësaj prone mbetet Kuvendi i Komunës Gjilan por shfrytëzimi i saj të shëndrrohet në " Komplex Memorial" dhe pjesa e mbetur e sipërfaqes prej 450858 m² (45.08.58 ha) të mos e ndryshon destinimin e saj.
5. Obligohet Investitori që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi paraprakisht të furnizohet me pëlqimin urbanistik në mënyrë që projekti në fjalë mos të bie në kundërshtim me Planet Hapësinore për këtë zone.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Nr.01. 016-126226
Gjilan, më 06.11.2014

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/